



Datë: 13.11.2024

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.829/350-60192

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14,15,17,19,20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve nenit 17, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031 neneve 44,47,48 lidhur me nenin 125, Rregullore mbi tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr.110-79262 datë 22.12.2023 si dhe konform Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021 dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, DUPM e Suharekë lëshnon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë – Komuna Suharekë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350/60192 datë 22.10.2024

Emri i Projektit:	Ndërtimi i Nënstacionit të Zjarrfikësve dhe Policisë në fshatin Studençan
Emri i Projektuesit:	“INNO GROUP” SH.P.K.
Adresa e Projektuesit:	Rr.Kostandin Kristoforidhi, Prishtinë

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II			
Adresa: Rruga” Arif Gashi ”-Studençan-Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikatat me numër referues: Nr. 2986/2024 datë 04.09.2024 Nr. 3704/2024 datë 05.11.2024	02269-1	Y=7480378335	X=4690658.123
		Y=7480384.754	X=4690663.463
		Y=7480390.763	X=4690656.240
	02270-0	Y=7480390.864	X=4690656.323
		Y= 7480396.896	X=4690649.049
		Y=7480389.208	X=4690642.654
		Y=7480383.164	X=4690649.918
		Y=7480383.268	X=4690650.004
		Y= 7480380.169	X=4690653.730
		Y= 7480381.245	X=4690654.625

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Ndërtim i Veçantë			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Sipërfaqja:	190.68 m ²	Etazhiteti:	P+0
Vija Rregullative:	Nga aksi i rrugës së planifikuar “Arif	Vija Ndërtimore:	Nga vija rregulluese 7.0m’

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë – Komuna Suharekë i lejohet "Ndërtimi i objektit të Nënstacionit të Zjarrfikësve dhe Policisë" në parcelat kadastrale **02270-0** Pronë e Komuna Suharekë sipas çertifikatës me numër referues 3704/2024 datë 05.11.2024 dhe **02269-1** pronë e P.Sh. Shkolla fillore 19 Nëndori Studençan tani SHFMU "Kongresi i Manastirit" sipas çertifikatës së pronës me Nr.2986/2024 datë 04.09.2024 Zona Kadastrale Studençan, duke mos e tejkaluar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me Hartën Zonale të Komunës, Kushtet ndërtimore dhe Udhëzimeve Administrative për këtë kategori të ndërtimit.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ku sipas gjendjes së planifikuar, parcelat kadastrale 2269-1 dhe 02270-0 formojnë bllokun ndërtimore me destinim Zonë Rekreative-Turistike ZrT-3të shfrytëzimet e lejuara dytësore– shërbimet komunitetit, andaj hapësira në fjalë do të shfrytëzohet për Nënstacion të Zjarrfikësve dhe Policisë me sipërfaqe bruto të objektit 190.68 m² dhe etazhitet P+0.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajné regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojné: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:

- Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë me përfaqësues Enver Shabani – Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/60192 datë 22.10.2024, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimin e objektit për Nënstacion të Zjarrfikësve dhe Policisë, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.242/24, datës 07.10.2024 lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë,
- Vërtetim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor Prizren nr. 3914 datë 19.09.2024,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.272 datë 09.09.2024,
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.1049, datë 02.10.2024.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Nr.03/03-112, datë 01.10.2024 nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë,
- Koordinatat e vendosjes së objektit sipas kushteve ndërtimore të punuara sipas gjeodetit të licensuar Shpend Morina.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë
- Pëlqim nga Drejtoria Komunale e Arsimit për ndërtimin e Nënstacioni të Policisë dhe Zjarrfikësve në parcelen kadastrale 02269-1 në Studençan.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, si dhe konform Projektit Kryesor “Nënstacion të Zjarrfikësve dhe Policisë” në Studençan dhe planeve të aplikueshme në Komunën e Suharekës si në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Pala lirohet nga pagesa në pajtueshmëri me nenin 22 pika 2 të Rregullores 01Nr.110-79262 datë 22.12.2023 për tarifat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI-sënë Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis– Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.829/350-60192 datë 13.11.2024

Vendimi i dërgohet: Parashtruesit të kërkesës; Inspektorit; Dosjes së DUPM-së

Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUÇI